



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DURRËS

DREJTORIA LIGJORE

SEKTORI I PROCEDURAVE LIGJORE DHE PROKURIMEVE PUBLIKE

Durrës, më 22.05.2026

PROCESVERBAL

Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: “*Blerje pajisje profesionale (aparate frymëmarrje AP3)*”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP): *Aparatë frymëmarrjeje për fikje të zjarrit 35111100-6.*

VLERA E FONDIT LIMIT: *4,982,500 (katër milion e nëntëqind e tetëdhjetë e dy mijë e pesëqind) Lek pa TVSH.*

Argumentim:

**MBI PËRGATITJEN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE PËRLLOGARITJEN E VLERËS
LIMIT TË KONTRATËS**

Në zbatim të urdhrat të grupit të specifikimeve nr.89 e nr.3647 prot., datë 12.03.2026 të Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkisë Durrës, “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e Specifikimeve Teknike si dhe Përllogaritjen e Fondit Limit, për procedurën e prokurimit me objekt: “*Blerje pajisje profesionale (aparate frymëmarrje AP3)*”, të planifikuar për tu kryer në programet e investimeve për vitin 2026-2028.

Grupi i specifikimeve teknike, pasi u njoh me objektin e prokurimit nëpërmjet dokumenteve:

- a. Sipas miratimit të Buxhetit Afatmesëm 2026-2028.
- b. Objektin.

dhe pasi i shqyrtoi ato, programoi punën për;

- a. Grumbullimin e informacionit, lidhur me Përcaktimin e Specifikimeve Teknike të Mallrave, objekt i këtij prokurimi, si dhe;

- b. Grumbullimin e informacionit, lidhur me Çmimet Orientuese në Treg, në mënyrë për të Përlllogaritur Vlerën Limit të Kontratës.

I. PËRCAKTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE:

Në përcaktimin e specifikimeve teknike, komisioni u mbështet në informacionin e marrë nga:

Pas shqyrtimit të informacionit mbi të dhënat teknike komisioni vërejt se:

Specifikimet Teknike të Përcaktuara në këto Dokumente janë në përputhje të plotë me kërkesat e Ligjit nr.162 datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 40.

II. PËRLLLOGARITJA E VLERES LIMIT TË KONTRATËS

Për përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, mbështetur në Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar me Ligjin nr.16/2024 Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, dhe VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, neni 76, sipas të cilit:

“Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë vijon: çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj); ose/dhe çmimet e Tregut; ose/ dhe çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga Autoritete të Tjera Kontraktore dhe /ose çmime ndërkombëtare të publikuara.”

Komisioni organizoi punën për kërkimin dhe grumbullimin e informacionit mbi çmimet orientuese në treg për të gjithë elementet e kostos së mallrave, objekt i këtij prokurimi.

Në përfundim të kërkimeve, u vërejt se:

1. Listat e publikuara nga INSTAT, nuk përmbajnë të dhëna mbi çmimet e mallrave që kërkohen të prokurohen.
2. Institucione të tjera zyrtare të njohura, nuk disponojnë publikime lidhur me çfarë kërkohet

Grupi u mbështet: Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor i referohet alternativës të renditur si më poshtë:

a) studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; në përzgjedhjen e disa firmave që operojnë në treg të lirë.

b) në çmimet e kontratave të mëparshme

Pas shqyrtimit të të dhënave teknike dhe informacionit të mbledhur të zërave bazuar në një metodologji të paracaktuar dhe pasi i përpunoi ato në një Tabelë Komplekse të Grumbullimit të Zërave të mallrave, rezultoi se: Vlera e përgjithshme e kontratës të jetë: 4,982,500 (katër milion e nëntëqind e tetëdhjetë e dy mijë e pesëqind).

Garancia e mallit do të jetë sipas specifikimeve teknike, bashkëngjitur.

Afatet e lëvrimit: 10 (dhjetë) ditë, nga nënshkrimi i kontratës.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Durrës ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

1. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: *Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe në mbeshtetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kriterëve të Përgjithshme të Përzgjedhjes/Kualifikimit të Shtojcës 8. (Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklarimit me shkrim të subjektivit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.)

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, nenin 40, pika 5, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.*

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit. *Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti kontraktor.*

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është vendosur në mbështetje të nenit 77, pika 3, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenit 43 pika 2, germa c) e 3, nenit 55 pika 4 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijimin e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën siç është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor. Vlera e kërkuar jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/c, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku parashikohet se “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar...” duke qenë se vlera e fondit limit të objektit përkatës është nën kufirin e ulët monetar kriteri hartohet në përputhje me vlerën procedurës. dhe nenin 55 pika 4 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se “Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkohen në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë”. Kërkesa është në përputhje me natyrën dhe vlerën e kontratës dhe nuk kufizon konkurrencën*

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin një dokument, të lëshuar nga administrata e njësisë së vetëqeverisjes vendore, ku ushtrojnë aktivitetin, që vërteton se kanë shlyer detyrimet për taksat dhe tarifat vendore për vitin e fundit financiar, përfshirë këstet e maturuara, në përputhje me afatet e maturimit të detyrimeve, sipas Ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, si dhe akteve përkatëse të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Ky dokument duhet të dorëzohet në sistem gjatë fazës së ofertimit. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë këtë vërtetim.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, e LPP-së i ndryshuar, si dhe të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i*

ndryshuar. Kjo kërkesë bazohet në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore. Shlyerja e detyrimeve vendore për vitin e fundit financiar, përfshirë këstet e maturuara, në përputhje me afatet e maturimit të detyrimeve, ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendndodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t'iu nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj. Gjithashtu referuar dhe ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 74 të tij.

2.3 Kapaciteti teknik dhe profesional:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tri) viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së fondit limit. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe neni 55, pika 4 germa b, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më të vogël se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar me cilësi kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si vërtetime/fatura tatimore, të deklaruara në organet tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.*

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim:

2.4.1 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë Certifikatë ISO 9001:2015, të standardit ndërkombëtar të menaxhimit të cilësisë dhe/ ose të njëvlefshme, të cilat do të garantonin cilësinë e produktit ose standard ISO më e avancuar, ku të jetë i përcaktuar objekti i prokurimit për tregtim të materialeve për shërbimin zjarrfikës (e përkthyer e noterizuar).

Argumentimi: *Kërkesat e mësipërme janë vendosur bazuar në Nenin 79, pika 1 të Ligjit Nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, sipas të cilit: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Nenit 44, pika 1 dhe 3 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.*

Certifikimi ISO 9001 ose ekuivalente është e nevojshme për garantimin e cilësisë së produkteve apo shërbimeve në mënyrë të qëndrueshme.

2.4.2 OE duhet të paraqesë prospekte teknike/ katalogët origjinale (ose kopje të noterizuar) përkatës ose ekuivalent i tyre, ku të tregohen karakteristikat teknike të mallit të ofruar, të cilat duhet të përmbushin specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor dhe të ofruara nga operatori ekonomik.

Argumentimi: *Në bazë të nenit të 77, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6/b, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Ky kriter lidhet drejtpërdrejt me objektin e prokurimit dhe synon të verifikojë në mënyrë të besueshme përputhshmërinë e produkteve me specifikimet teknike të kërkuara.*

2.4.3 OE duhet të dorëzojë patjetër një aparat frymëmarrje të kompletuar (një samar, një bombul dhe dy maska), të cilat duhet të shikohen fizikisht nga specialistët e fushës (M.Z.SH).

Argumentimi: *Në bazë të nenit të 77, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Ky kriter lidhet drejtpërdrejt me objektin e prokurimit dhe synon të verifikojë në mënyrë të besueshme përputhshmërinë e produkteve me specifikimet teknike të kërkuara.*

2.4.4 Operatori Ekonomik duhet të paraqes një deklaratë në të cilën merr përsipër lëvrimin e mallrave objekt prokurimi në sasinë dhe cilësinë e kërkuar sipas kërkesave të autotiretit kontraktor brenda afatit kohor.

Argumentim: *Ky kriter vendoset në përputhje me Ligji Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, dhe synon të garantojë që operatori ekonomik ka kapacitetet e nevojshme për realizimin në kohë të lëvrimin të mallrave. Kriteri është proporcional dhe i lidhur drejtpërdrejt me objektin e kontratës, pasi transporti dhe dorëzimi i mallrave pranë magazinës së Bashkia Durrës do të realizohet me mjetet dhe personelin e operatorit ekonomik fitues.*

Të gjithë dokumentet duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumenteve të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

II Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike të hartuara nga struktura e posaçme e ngritur me urdhër të titullarit të autoritetit kontraktor, plotësojnë kushtet e përcaktuara nënenet 36 dhe 77 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Specifikimet teknike janë hartuar në funksion të përmbushjes së nevojave reale të autoritetit kontraktor dhe garantimit të sigurisë, cilësisë dhe eficiencës në përdorimin e pajisjeve profesionale të frymëmarrjes autonome (SCBA/AP3) për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”. Kërkesat teknike lidhen drejtpërdrejt me natyrën e shërbimit zjarrfikës, ku pajisjet përdoren në ambiente me temperatura të larta, tym, gaze toksike dhe kushte me rrezik të shtuar për jetën e efektivëve. Për këtë arsye janë kërkuar materiale rezistente ndaj nxehtësisë, goditjeve dhe kimikateve, sisteme sigurie dhe alarmi. Specifikimet mbi bombulat, maskat, presionin e punës, temperaturat e funksionimit dhe elementët e integruar të sistemit janë përcaktuar për të siguruar funksionim të qëndrueshëm dhe efikas gjatë operacioneve të emergjencës, si dhe për të minimizuar rrezikun operacional gjatë ndërhyrjeve zjarrfikëse dhe shpëtimit. Këto specifikime janë hartuar duke respektuar parimet e konkurrencës, proporcionalitetit dhe mosdiskriminimit, pa kufizuar pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë, por duke garantuar që pajisjet e furnizuara të përmbushin standardet minimale të nevojshme teknike dhe të sigurisë për përdorim profesional nga strukturat e MZSH-së.

Specifikimet teknike dhe fondi limit i kontratës janë hartuar prej Autoritetit Kontraktor për nevojat e së cilës po kryhet kjo procedurë prokurimi.

Specifikime teknike, preventivi, afati dhe kriteret kualifikuese u pasqyruan në DT,

Dokumentet e tenderit me kërkesat si më sipër firmosen nga anëtarët e njësisë së prokurimit, pas miratimit të gjithë anëtarët e njësisë kanë akses (autorizohen) për botimin e tyre në rrugë elektronike pranë APP(www.app.gov.al).

Njësia e Prokurimit